



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 135, datë 16.04.2020

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOZHSHËM PËR HARTIMIN, PROPOZIMIN DHE MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË NJË PLANI MASASH PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË E SHËRBIMEVE GJYQËSORE NË MËNYRËN MË TË SIGURT TË MUNDSHME GJATË KOHËZGJATJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA VIRUSI COVID-19

Këshilli i Lartë i Gjyqësor bazuar në nenet 147/1, 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 pika 2 shkronja “j”, 62 pika 14 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 7, 36 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, në nenin 42 të Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, me propozim të tre anëtarëve të Këshillit, z. Erjon Muharremaj, zj. Brikena Ukperaj dhe z. Dritan Hallunaj,

VE ND O S I :

1. Ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, me qëllim ushtrimin e veprimtarive e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19.
2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga pesë anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe tre anëtarë gjyqtarë, të zgjedhur nga Mbledhja Plenare, si më poshtë:

- Znj Naureda Llagami - Kryetar;
- Z. Medi Bici - anëtar;
- Znj. Brunilda Kadi - anëtar;
- Znj. Marcela Shehu - anëtar;
- Z. Erjon Muharremaj - anëtar.

3. Në përmbushje të detyrave të tij sipas pikës 1, Komisioni i Përkohshëm kryen analizën e kuadrit ligjor në fuqi dhe bashkëpunon me këshillat e gjykatave, kryetarët dhe kancelarët e tyre, për të evidentuar të gjitha problematikat që shfaq infrastruktura e gjykatave, me synimin e

kufizimit të efekteve negative që epidemia shkakton në ushtrimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore.

4. Masat e propozuara nga Komisioni i Përkohshëm e të miratura nga Mbledhja Plenare, mund të zhvillohen e ndryshojnë në dinamikë, në varësi të ecurisë së epidemisë.

5. Komisioni i Përkohshëm ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundim të gjendjes së epidemisë.

6. Në mbledhjet e tij Komisioni mund të ftojë të marrin pjesë përfaqësues të Misionit EURALIUS V, dhe të projektit “Drejtësi për të gjithë”-USAID.

7. Në përmbushjen e detyrave të tij, komisioni do të asistohet nga personeli administrativ i Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR